



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
 DHE ENERGJISË**

**AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË  
 DHE EMERGJENCAT NË MINIERA**

Nr. 1364/1 Prot

Tiranë, më 04 / 12 / 2017

LËNDA: Jepet informacioni i kërkuar

KËRKUESIT: BIRN Albania  
 Z. Sami Curri (sami.curri.sc@gmail.com)

TIRANË

Në cilësinë e kërkuarit, keni depozituar pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën për dhënie informacioni, regjistruar me numër rendor 1364 prot, datë 22/11/ 2017, në lidhje me aksidentet me pasojë vdekjen e dy punonjësve, të ndodhura në subjektin minerar “BRISEL” sh.p.k, që ushtron veprimtari në zonën mineral mbajtëse D, në Bulqizë.

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, ju informon si më poshtë:

**Rasti 1** – Më datë, 25.10.2017, rreth orës 08:00, në subjektin minerar “BRISEL” sh.p.k, me leje minerare nr. 1489/2, datë 02.08.2010, vendburimi zona “D”, Rrethi Bulqizë, traverbangu A, hz+1200, ndodhi aksidenti me pasojë vdekjen e punëtorit Eris Fiqiri Keta. I aksidentuari, Eris Fiqiri Keta ka lindur në Bulqizë më 03.06.1987, banues në Bulqizë, i martuar, me fëmijë, me profesion vagonist, i instruktuar për herë të fundit më datë 18.10.2017.

*Vëndi i ndodhjes së aksidentit:*

Aksidenti me pasojë vdekjen e shtetasit, ka ndodhur në traversën majtas degëzimi djathtas, të nënkatit të tretë (+23m nga punimi kryesor), të degëzimit djathtas të galerisë A1, midis profileve XLIX – LI, të traverbangut A H+1200, e cila është e përfshirë në lejen minerare nr. 1489/2, datë 02.08.2010, nën administrimin e subjektit minerar “BRISEL” sh.p.k.

*Rrethanat e ndodhjes së aksidentit:*

Në fillim të turnit të parë të datës 25.10.2017, brigadieri Ismet Disha, së bashku me grupin e punës të përbërë nga minatori Ilir Balla, armatori Rrahman Hupi dhe punëtori Eris Keta, në bazë

të udhëzimeve teknike, të datave 24 dhe 25.10.2017, të lëna nga tekniku i sektorit, kishin për detyrë të bënin armatimin dhe avancimin e frontit, traversa e sapo filluar majtjas (avancuar rreth 2.5 ml) në nënkatin e tretë.

Sipas deponimit të brigadierit, Ismet Disha, i pranishëm në vend ngjarje, rreth orës 07:50, grupi i punëtorëve të mësipërm, ka arritur pranë frontit të punës dhe janë ulur për t'u çlodhur (për shkak të ngjitjes vertikale në furnelin 23 ml). Papritur, punëtori Eris Keta është shpëputur prej tyre dhe ka hyrë në traversën ku do të punonin për vendosjen e armatimit, pa u kontrolluar më parë prej minatorit dhe armatorit. Në këtë moment, prej punëtorëve të pranishëm të cilët ndodheshin rreth 3 – 4 ml larg traversës, është dëgjuar zhurma e rrëshqitjes së gurëve dhe britma e punëtorit. Menjëherë punëtorët kanë shkuar drejt traversës dhe kanë vënë re punëtorin Eris Keta të rrëzuar në tokë dhe të goditur prej gurëve të shpëputur nga faqja anësore e krahut të majtë të traversës. Punëtorët kanë marrë të aksidentuarin, në gjëndje të rëndë dhe e kanë nxjerrë nëpërmjet rrugë kalimit për në sipërfaqe. Sapo ka arritur në spitalin e Bulqizës, i aksidentuari ka ndërruar jetë.

*Shkaku i ndodhjes së aksidentit:*

Duke analizuar ngjarjen si dhe kqyrur vëndin e ndodhjes së saj, grupi i ekspertëve arrin në përfundimin se aksidenti me pasojë vdekjen e punëtorit Eris Keta, ka ndodhur për shkak të ekspozimit në hapësirën e paarmatosur dhe për rrjedhojë goditjen nga një masiv shkëmbori shpëputur nga faqja anësore e punimit në avancim. Në vëndin e ngjarjes, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, ka marrë *këto masa paraprake*:

1. Të ndalohet menjëherë aktiviteti në nënkatin e tretë të degëzimit djathtas të galerisë A1, midis profileve XLIX – LI, të traverbangut A hz+1200
2. Të bëhet analiza e aksidentit në subjekt, të nxirren shkaqet, personat përgjegjës dhe masat që do të merren për përmirësimin organizativ e teknik në subjekt. Konkluzionet e analizës të paraqiten në AKSEM, më datë 30.10.2017.
3. Të bëhet riistruktimi i posaçëm për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për të gjithë punëtorët që punojnë në punimet nëntokësore.

Pas përfundimit të analizës së aksidentit të zhvilluar pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, u lanë detyra specifike, si dhe dënimi kryesor “paralajmërim” dhe dënim plotësues “masë administrative me gjobë”

Detyrat e lëna për t'u zbatuar, nga subjekti “BRISEL” sh.p.k:

1. Të bëhet menjëherë riistruktimi i posaçëm, për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për të gjithë punëtorët që punojnë në punimet nëntokësore.
2. Të emërohet menjëherë një specialist minerar, i cili do të merret vetëm me problemet e sigurimit teknik.
3. Duke qënë se, numri i punëtorëve të këtij subjekti është relativisht i madh, nga subjekti të merren masa për të organizuar shërbimin e specializuar të ndihmës së shpejtë mjekësore pranë subjektit (brënda muajit nëntor 2017).

**Rasti 2** – Më datë 15.11.2017, rreth orës 12:00, në subjektin minerar “BRISEL” sh.p.k, traverbangu A, hz + 1200, Zona “D”, Bulqizë, ka ndodhur një aksident, me pasojë vdekjen e punëtorit Eduart Naim Dama. I aksidentuari, Eduart Naim Dama ka lindur në Bulqizë më 19.06.1990, banues në Fushë – Bulqizë, i pamartuar, me profesion minator, instruktuar për herë të fundit më 27.10.2017.

*Vëndi i ndodhjes së aksidentit:*

Aksidenti i datës 15.11.2017 me pasojë vdekjen e shtetasit Eduart naim Dama, ka ndodhur në nënaktin e I-rë të degëzimit majtas të degëzimit 3 A të galerisë A hz+1200 m, e ciola është e përfshirë në lejen minerare nr. 1489/2, datë 02.08.2010, nën administrimin e subjektit minerar “BRISEL” sh.p.k.

*Rrethanat e ndodhjes së aksidentit:*

Urdhëri i punës i lëshuar nga Tekniku i Objektivit Z. Miftar Hupi, ka qënë për të punuar grupi i punës i përbërë nga minatori Eduart Dama (i aksidentuari) dhe ndihmësi në ringritje të galerisë së nënaktit I-rë, të degëzimit majtas, të degëzimit 3A, pr. LVII – LIX. Galeria e nënkatit ka qënë e armatosur me katrore druri në gjatësi rreth 18 deri në 20 ml deri në ball të punimit. Pranë ballit, në distancë 1.5 – 2 ml, në krahun e majtë ishte hapur një traversë e cila lidhej me dyshtenë e një punimi të vjetër, i cili ndodhej +2ml disnivel. Në kundërshtim me urdhërin e punës së dhënë për të punuar në ringritje të galerisë së nënkatit, minatori është ekspozuar në traversën majtas galerisë që lidhej me punimin e vjetër. Në këtë moment nga tavani i punimit të vjetër është shkëputur një masë shkëmbore nga një lartësi rreth 4 m, duke goditur minatorin dhe për pasojë duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme. Trupi i të aksidentuarit me ndihmën e punëtorëve të tjerë është transportuar për në sipërfaqe.

*Shkaku i ndodhjes së aksidentit:*

Duke analizuar ngjarjen, si dhe kqyrur vëndin e ndodhjes së saj, grupi i ekspertëve arrin në përfundimin se, minatori Eduart Dama është ekspozuar në traversën e paarmatosur që lidhej me punimin e vjetër (jashtë vëndit të tij të punës) dhe për rrjedhojë është goditue nga një masiv shkëmbor i shkëputur nga tavani i galerisë së vjetër. Hyrja e traversës majtas galerisë së nënkatit që lidhej me punimin e vjetër duhej të ishte e bllokuar që të mos lejohej kalimi i punonjësve.

Në vëndin e ngjarjes, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, ka marrë këto masa paraprake:

1. Vendim i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente për pezullim tërësorë të veprimtarisë prodhuese për lejen minerare nr. 1489/2, datë 02.08.2010, pa afat, bazuar në ligjin nr. 135/2016 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtaritë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike”, neni 23.
2. Për subjektin “BRISEL” sh.p.k merret masa administrative e dënimit me gjobë në vlerën 200 000 lekë, bazuar në ligjin nr. 135/2016 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtaritë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike”, neni 22, pika 1, gërma “c”
3. Për subjektin minerar “BRISEL” sh.p.k merret masa administrative e dënimit me gjobë në vlerën 300 000 lekë, bazuar në ligjin nr. 135/2016 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë,

emergjencat dhe shpëtimin në veprimtaritë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike”, neni 22, pika 1, gërma “d”.

4. Të bëhet analiza e aksidentit në subjekt, dhe të nxirren shkaqet, personat përgjegjës dhe masat që do të merren për përmirësimin organizativ e teknik në subjekt. Konkluzionet e analizës të paraqiten në AKSEM, më datë 20.11.2017.
5. Pas analizës në subjekt, të kontrollohet me grup punë të posaçëm nën drejtimin e drejtuesit teknik të gjitha punimet minerare nëntokësore të dokumentohen të gjitha mangësitë teknike dhe të hartohet një plan masash konkrete për riparimin dhe eliminimin e këtyre mangësive.

Pas përfundimit të analizës së aksidentit të zhvilluar pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, përfundimisht, ndaj subjektit minerar “BRISEL” sh.p.k, u vendos:

1. Pezullim tërësor të veprimtarisë prodhuese për lejen minerare nr. 1489/2, datë 02.08.2010, pa afat bazuar në ligjin nr. 135/2016 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtaritë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike”, neni 23.
2. Tekniku i sektorit Myftar Hupi të shkarkohet nga detyra.
3. Të zbatohet në drejtimin e drejtuesit teknik plani i masave hartuar nga subjekti për kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme në të gjitha punimet e objektit. Aktiviteti prodhues do të rifillojë vetëm mbas njoftimit dhe kontrollit nga inspektorët e AKSEM-it për realizimin e detyrave.
4. Të merren masa të menjëhershme për zëvendësimin e përkohshëm të drejtuesit teknik me një inxhinier minierë, si dhe emërimin e menjëhershëm të një specialisti minerar në detyrën e përgjegjës të sigurimit teknik për subjektin i cili duhet të ndjekë vetëm problemet e sigurimit teknik.
5. Për shkeljet e mësipërme, ndaj subjektit minerar “BRISEL” sh.p.k u vendos masa administrative e dënimit me gjobë, në vlerën 500000 lekë, bazuar në ligjin nr. 135/2016 “për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtaritë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike”, neni 22, pika 1, gërma “c” dhe “d”.

